

## **HORIZON 2020 – REZULTATET E PARA**

Komisioni European ka publikuar së fundmi “Horizon 2020 – Rezultatet e Para”, duke ndarë kështu të dhënat e mbledhura gjatë vitit të parë të impementimit të Horizon 2020, Programi kuadër për kërkimin dhe inovacionin i Bashkimit European për vitet 2014 – 2020.

Në 1 Dhjetor 2014, janë mbyllur 100 thirrje për propozim. Sipas ndarjeve të Programit:

- 20 ishin nën Shkenca Ekselente,
- 26 ishin nën Lidërshipi Industrial,
- 43 ishin nën Sfidat Shoqërore,
- 3 ishin nën Shpërndarja e Ekselencës dhe Zgjerimi i Pjesëmarrjes,
- 5 ishin nën Shkenca me dhe për Shoqërinë,
- 3 ishin nën Programi Euratom për Kërkimin dhe Trajnimet 2014-2018.

Numri total i propozimeve të marra ishte 36 732:

- 29 794 propozime të plota në thirrje me një fazë
- 5 617 propozime të shkurtra të fazës së parë për thirrjet me dy faza
- 1 321 propozime të plota në fazën e dytë të thirrjeve me dy faza


Nga këto, 4 315 propozime u mbajtën për financim; pra niveli i përgjithshëm i suksesit për propozimet e plota të vlefshme (pa konsideruar propozimet e shkurtra në fazën e parë të thirrjeve me dy faza) është rreth 14%.

Duke vëzhguar këtë numër të aplikimeve të vlefshme për shtet, është interesant vizualizimi i cilave shtete europiane janë më aktive, dhe se si shtetet anëtare më të fundit po përshtaten me këtë program të ri për kërkimin dhe inovacionin.

Anglia, Gjermania dhe Italia zënë 3 vendet e para. Sidoqoftë, nëse doni të shihni pikturën e plotë, shikoni këtë tabelë, të renditura sipas shteteve:


## How many applications have been received?

Number of eligible applications to Horizon 2020 per EU Member State



## What are the success rates of the different Member States?

Success rates for applications to Horizon 2020 per EU Member State



Faktikisht, Franca, Belgjika dhe Austria fitojnë podiumin për aplikimet e suksesshme – ato ishin respektivisht e 5-ta, e 7-ta dhe e 10-ta për numër aplikimesh.

Natyrisht që ka një hark mësimi që lejon organizatat të përmirësojnë aftësitë e shkrimit të propozimeve, krijimin e konsorciumit, zgjerrimin e rrjeteve, si dhe dizenjimin e planit për një punë me kosto efektive dhe realiste: ky është një lloj provimi dhe proces me gabime për të gjithë. Prandaj nuk është çudi që shtete e reja dhe shtetet e vogla janë në fund të listës.

Ndërkohë, 38% e aplikimeve të suksesshme ishin nga të rinjtë, të përkufizuara nga Komisioni si organizata që nuk kanë marrë pjesë në FP7.


### **Mësimi i parë: bëni detyrat tuaja.**

Nuk ka rëndësi nëse kjo është hera e parë që ju merrni pjesë në Horizon 2020 ose çdo program tjetër i BE-së, shancet tuaja për të fituara nuk ulen nga fakti që jetoni në një shtet më të vogël ose shtet i ri antar, nëse ju dini të shkruani një propozim të vlefshëm.

Ky argument shpjegohet më së miri kur shikoni nivelet e suksesit të çdo shteti nën instrumentin e SME-ve.


#### **What is the breakdown by country for the SME instrument?**

Applications to the Horizon 2020 SME instrument per EU Member State



Shumica e aplikimeve të vlefshme u dorëzuan nga 5 Shtetet më të mëdha Antare të BE-së: Italia, Spanja, Anglia, Gjermania dhe Franca. Sidoqoftë, bazuar në nivelin e suksesit, 5 shtetet e para janë: Malta, Irlanda, Suedia, Danimarka dhe MB.

Po, e lexuat mirë: Malta ka dorëzuar numrin më të madh të aplikimeve të suksesshme për Horizon 2020 nën instrumentin e SME-ve në 2014, duke shënuar 20% të nivelit të suksesit – shumë mbi mesataren e BE-së prej 7.3%.



Në 2014, **të rinjtë u mirëpritën edhe me bashkimin e ekspertëve**, duke qenë se 58.2% e vlerësuesve të propozimeve nuk morën pjesë në FP7.

Edhe pse një krahasim me figurat e FP7 është i padrejtë, duke qenë se Horizon 2020 ka vetëm 1 vit që vepron, është shume e qartë që Horizon 2020 është më i aksesueshëm dhe më tërheqës, duke çuar kështu edhe në uljen e mundësive për të fituar.

Mos u frikësoni, sepse kjo nënkupton që vetëm propozimet më të mira do të fitojnë, prandaj ju thjesht po shtyheni të bëni më të mirën.

Në përgjithësi, një total prej 3236 **marrëveshesh granti** janë firmosur në fund të Prillit 2015, me një mazhorancë marrëveshesh (95%) të firmosura brenda “Kohës së Grantit” të parashikuar, koha mes mbylljes së thirrjes dhe firmosjes së marrëveshjes së grantit, e cila shënon fillimin zyrtar të projektit.

I urojmë fat të gjithë kolegëve që kanë dorëzuar një propozim dhe janë në pritje të vlerësimit; nëse ju jeni një nga menaxherët e projektit që firmosët një marrëveshje granti, ndajeni me ne historinë tuaj të suksesit – do të donim shumë ta dëgjonim!